

RELACION MBI VIZITEN NË VENDIN TONË TE PROF. J. BRIHAYE

DHE PROF. G. FORUGLOU

Dr. ^{nja Univeriteti i Brukselit}
Prof. J. Brihaye Nënkyetar i parë i Shoqatës botërore

të neurekurgjisë dhe Kryetar ndëri i Shoqatës Europiane të Neurekurgjisë arriti në Shqipëri më dt 8.12.1986. U prit në aeroportin e Kinast nga Dr. Xh.Kurti, Dr.A.Xhumari dhe Dr.M.Petrela.

Me vizitën e tij ai kërkoi të njihte nivelin e neurekurgjisë në vendin tonë dhe si rezultat të shikonte mundësinë e pjesëmarrjes në Bashkimin e Shoqatave Europiane të neurekurgjisë.

Më dt 10.12.1986 arriti në vendin tonë Prof.G.Foruglou nga Universiteti i Selanikut N/Kryetar i Shoqatës Europiane të neurekurgjisë dhe përgjegjës për zonën jugore Turqi, Greqi, Itali, Spanjë, Portugali, Jugosllavi dhe Qipre. Ai u prit në Kakavijë nga Dr.A.Xhumari dhe Dr.Xh.Kurti. Qëllimi i vizitës ishte i njëjtë me të Prof.Brihaye

Pasi kryen vizita në qendra kulturore industriale të vendit sipas programit të hartuar më parë nga Ministria e Shëndetësisë ata u ajuhën se përparimet dhe arritjet në fusha të ndryshme të jetës në vendin tonë. Shpesh herë ata theksuan se këto arritje nuk do të ishin të realizueshme pa pasur një drejtim të mirë dhe pa punë këmbëngulëse nga i gjithë populli. Prof. Brihaye theksonte se shikoj një popull të luatur ndërsa Prof. Foruglou u shpreh se duke qënë se miqësia e popullit Shqiptar me Greq është e vjetër nuk arrij të kuptoj se si mbahet ligji i luftës. Ai ishte i bindur se si çështja e Vericepivit dhe çështja e Qipres nxiten nga disa forca të errëta në Greqi. Ai ishte kundër këtyre pikpamjeve dhe ish vënë në operitë me këto forca të cilat nuk e shikonin me sy të mirë vizitat që kishte bërë në Turqi eshtu siç mund të thohet dhe për vizitat në Shqipëri.

Nga Hotel " Dajti " Prof. G.Foruglou dhe Prof. J.Brihaye i dërguan një mesazh Prof.F.Isamat Kryetar i Shoqatës Europiane të Neurekurgjisë ku shkruania : Arritëa në Shqipëri, një vend i

marekullueshëm , midis ajërësish të marekullueshëm .

Më dt 12.12. ata u pritën nga Dekani i Fakultetit të Mjekësisë Dr. Veli Zogu dhe zhvilluan me të një bisedë miqësore ku theksuan rrethat që duhet të luajë neurokirurgjia në procesin mësimor jo e varur nga neurologjia por si degë më vete si Katedër , Sipas eksperiencës të vendeve më të mëdha dhe regjioneve më të vogla si ai i Selanikut neurokirurgjia ka program të veçantë universitar dhe postuniversitar. Këto programe ata premtuan t'ja dërgojnë Dekanit dhe do të vazhdojnë të insistojnë në këtë drejtim në të mirën e zhvillimit të mjekësisë Shqiptare

Po atë ditë ata zhvilluan një staf të përbashkët me gjithë neurokirurgët , neuroradiologët , neurologët ku diskutuan rastet; u njohën me projektin e klinikës së neurokirurgjisë dhe të Saknerit . Nga stafi dhe diskutimi mbetën shumë të kënaqur për nivelin diagnostik kirurgjikal dhe indikacionet neurokirurgjikale e për perspektivën që i hapet neurokirurgjisë me ndërtimin e klinikës .

Në orën 12 ata u pritën nga Ministri i Shëndetsisë dhe zhvilluan me të një bisedë të singertë miqësore ku shprehën konsideratën për zhvillimin e neurokirurgjisë dhe kontributin që jep qeveria në këtë drejtim. Ata theksuan se niveli i neurokirurgjisë Shqiptare është bashkëkohor . Kjo duhet vlerësuar e duhet që dhe Shqipëria të thotë fjalën e saj në feruset e ndryshme të shkencës , në Kongrese , simpoziume , kurse kualifikimi etj, aqtu siq bëjnë edhe vende të tjera . Në këtë zhvillim meriten të përmenet edhe kontributi i Dr. Xh.Kurti. Ata thanë se **Bashkimi i Shoqatave të Neurokirurgjisë të Europës (BSHAM)** si një organizatë e fuqishme në gjirin e shoqatës botërore të neurokirurgjisë dhe me lidhjen që ka me Organizatën Botërore të Shëndetsisë mendon se **Shqipërisë i takon dhe i ka mundësitë që të zërë vendin e duhur në BSHAM.**

Sipas kushtetutës ata sugjeruan që Shoqata Shqiptare eë uniteti si mund ta quajmë duhet të jetë i përbërë prej jo më pak se anëtarësh ku duhet të marrin pjesë jo më pak se 20 anëtarë.

neurokirurgë , neuroradiologë dhe specialistë të fushave të afërta me një kuotë simbolike rreth 15 franga zviceriane për anëtarë.


BSHEN ofron pjesëmarrjet në Kongreset e saj që mbahen çdo katër vjet , simpoziumet që organizohen për problemet e ndryshme ku duhet të marrin pjesë neurokirurgë nga e gjithë Europa . Ajo organizon çdo vit kurse postuniversitare me neurokirurgët e rinj që duhet të dinë anglisht mbi probleme të ndryshme për një javë . Në fund të një cikli pesëvjeçar ata pajisen me dipllomë pasi numëri i pjesëmarrësve është i kufizuar . Prof. Brihaye mendoi që kërkimet duhet të mi dërgoni shumë më përpara pasi pranohen vetëm 50 kirurgë në vit .

Ata propozuan gjithashtu që në Komitetin shkencor të Organizatës Europiane të neurokirurgjisë të BSHEN të marrë pjesë një anëtar shqiptar që të komunikojë anglisht dhe sygjerasa Dr. Mentor Petrelën . Ky Komitet mbledhet çdo vit në vende të ndryshme të Europës dhe diskuton mbi tematikën e Kongreseve , seminareve , drejton kurset vjetore të kualifikimit të neurokirurgëve të rinj , studion dosjet dhe pranon kandidatët e rinj . Anëtarët e këtij Komiteti shkencor të BSHEN duhet të mbajnë leksione në kurset e kualifikimit që organizohen gjatë këtyre mbledhjeve . Në fund të bisedës ata falenderuan Ministrin e Shëndetësisë për pritjen e ngrohtë .

Prof. Brihaye dhe Prof. G. Foroglou mbajtën dy leksione me neurokirurgët dhe specialistët e ardhur nga i gjithë vendi të cilat u ndeqën me interes . Në fund të vizitës , në darkën e lamtumirës që u dha në Hotel "Dajti " morën pjesë Ministri i Shëndetësisë Dr. Ajli Aluehani , Dr. Gjergji Minga , Dr. Isuf Kalo , Dr. Xh. Kurti , Dr. A. Xhumari , Dr. M. Petrela . Ata theksuan se konkluzionet e vizitës dhe rezultatet e bisedimeve si dhe sygjerimet do të dërgonin në mënyrë zyrtare pasi të diskutohen dhe në Këshillin administrativ të BSHEN .

Ata u larguan nga vendi ynë më dt 15.12.1966 dhe u përcollën në Kapshticë nga Dr.Xhelal Kurti, I.Leka dhe në Rijas A.Xhumari dhe Dr.M.Petrela .

Dr.M.Petrela



Dr.Xhelal Kurti



Dr.A.Xhumari

